



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

V E N D I M

Nr.29. Datë.03/09/2025

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË ORARET DHE LINJAT RRETHQYTETËSE
TË TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE**

Këshilli i Qarkut Korçë, në mbledhjen e datës 03 .09.2025, mbështetur në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", i ndryshuar, neni 15, pika 1, gërma "ç" dhe paragrafi i dytë i nenit 19, si dhe në kërkesën e Bashkisë Maliq nr. 4518, datë 19.08.2025, për disa shtesa dhe ndryshime në oraret e linjave rrethqytetëse, me propozim të Kryesisë,

V E N D O S I:

1. Të miratojë shtesat dhe ndryshimet në oraret dhe linjat rrethqytetëse të transportit të udhëtarëve, sipas itinerareve të paraqitura në kërkesën e Bashkisë Maliq.
 2. Shtesat, ndryshimet e orareve dhe pikat e nisjes e të mbërritjes së mjeteve përcaktohen sipas tabelës bashkëngjitur këtij vendimi.
 3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave në Bashkinë Maliq.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Erjon Nexhipi



Miratuar me 17 / Vota
Vota Pro 17 / Vota
Vota Kundër 0 / Vota
Vota Abstenim 0 / Vota
Zbardhur më datë 03/09/2025
Koncept: R.Latollari 
Këshilltari juridik: M.Bylykbashi 
Sekretari i KQK: B.Muşo 
Nr. ekzemplarëve: 3(tre)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

Nr. _____ Prot.

Korçë, më ____ .09.2025

RELACION

**PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË ORARET DHE LINJAT RRETHQYTETËSE
TË TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE**

Më datë 21.08.2025, pranë Këshillit të Qarkut Korçë, është regjistruar kërkesa e Bashkisë Maliq me nr. 4518 prot., datë 19.08.2025, për disa ndryshime në oraret dhe linjat rrethqytetëse të transportit të udhëtarëve.

Në kërkesë parashikohet:

- Shtimi i orareve të linjave rrethqytetëse për transportin e pasagjerëve nga fshati Pîrg drejt qytetit të Pogradecit dhe kthim;
- Ndryshimi i disa orareve të linjës Podgorie – Pogradec – Kthim.

Bazuar në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, “Për transportet rrugore”, i ndryshuar neni 15 pika “ç”, neni 19 paragrafi 2 dhe 3, si dhe në Vendimin e Këshillit nr. 12, datë 15.03.2024, “Për miratimin e linjave rrethqytetëse të transportit të udhëtarëve”, i ndryshuar me Vendimin nr. 37, datë 13.09.2024, mbi bazën e të cilëve ushtrojnë aktivitet subjektet që operojnë në fushën e transportit në Bashkinë Maliq, paraqitet për shqyrtim në Këshillin e Qarkut kërkesa e Bashkisë Maliq.

Në këto kushte, sipas kërkesës së sipërpërmendur, paraqitet për miratim lista e linjave dhe orareve përkatëse, e cila i bashkëngjitet këtij relacioni.

Dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, “Për transportet rrugore”. I propozojmë Këshillit të Qarkut Korçë miratimin e kërkesës së paraqitur.

NJËSIA E BURIMEVE NJERËZORE

Redin Latollari



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

**LISTA ME SHITESAT DHE NDRYSHIMET NË ORARET DHE LINJAT RRETHQYTETËSE
TË TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE
(dërguar nga sektori mekanik i Bashkisë Maliq)**

Lista e re me oraret përkatëse:

Linja e re	Pirg – Pogradec – Pirg			
Nisja	08:30	10:30	12:30	14:30
Kthimi	09:30	11:30	14:00	15:30

Ndryshimi dhe shtimi i orareve

Oraret e linjave para ndryshimit:

Linja	Podgorie – Pogradec - Podgorie						
Nisja	07:30	09:00	10:00	12:00	14:00	15:00	16:00
Kthimi	9:30	12:30	13:30	14:30	15:30	16:30	17:30

Oraret e linjave me ndryshimet:

Linja	Podgorie – Pogradec - Podgorie							
Nisja	08:15	09:15	10:15	11:15	12:15	13:15	14:15	15:15
Kthimi	09:45	10:45	11:45	12:45	13:45	14:45	15:45	16:45